



## Propozime nga DIHA

### Proposals from the DIHA

#### COVID - 19

1. Riskedulimi i detyrimeve të kompanive ndaj Qeverisë në gjysmën e dytë të vitit 2020.  
*Postponement of the deadlines of companies' liabilities to the Government to the second half of 2020.*
2. Krijimi i një kuadri ligjor për pagën mujore të reduktuar në bazë të orarit të punës së reduktuar për bizneset e prekura nga masat e karantinës.  
*Creating a legal framework for reduced monthly salary based on reduced working hours for businesses affected by quarantine measures.*
3. Përpilimi i një kuadri ligjor për reduktimin e detyrimeve (qira, taksa etj.), që rrjedhin nga kontratat B2B apo B2G për bizneset e prekura nga masat e karantinës.  
*Drafting a legal framework for the reduction of liabilities (rent, taxes, etc.), which arise from B2B or B2G contracts for businesses affected by quarantine measures.*
4. Mosaplikimin e penaliteteve/kamatvonesave/interesave për çdo deklaram tatimor për periudhën gjatë Covid-19.  
*Not applying penalties/interests for each tax declaration for the period during Covid-19.*
5. Liberalizimi i masave shtrënguese për të lejuar operativitetin e bizneseve që mund të garantojnë kushte sigurie dhe distancim social. Duhet të hartohet një plan strategjik për reduktimin e masave të karantinës për hapjen e sektorëve të caktuar, hap pas hapi.  
*Liberalization of coercive measures to allow the operation of businesses that can guarantee security conditions and social distancing. A strategic plan should be drawn to reduce quarantine measures step by step, in order to open up certain sectors.*
6. Aplikimin e ndihmave për pagën e luftës ose për kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për bizneset me xhiro mbi 14 milione Lekë.  
*Applying a wage assistance or contributions for social and health insurance for businesses with a turnover over 14 million Lekë.*



7. Pagimin e menjëhershëm të të gjithë detyrimeve të prapambetura për kompanitë që kanë ofruar shërbime apo mallra publike, rimbursim TVSH apo detyrime të tjera.  
*Immediate payment of all arrears for companies that have provided public services or goods, as well as VAT refund or other liabilities.*
8. Përshpejtimin e procedurave të pagesave nga shteti apo ndërmarrjeve shtetërore për shërbimet apo produktet që lëvrohen nga kompanitë.  
*Accelerate the payment procedures by the state or state-owned enterprises for services or products provided/delivered by companies.*
9. Aktivizimi i menjehershëm i Fondit të Rindërtimit nga tërmeti si dhe përshpejtimi i procedurave për dhënien e lejeve të ndërtimit si një mjet i rëndësishëm për nxitjen e sektorit të ndërtimit.  
*Immediate activation of the Reconstruction Fund from the earthquake as well as the acceleration of the procedures for issuing building permits as an appropriate tool for promoting the construction sector.*
10. Nxitje nëpërmjet lehtësimit të taksave në sektorët e turizmit dhe bujqësisë do të sillte rritjen e ofertës dhe vitalizimin e këtyre sektorëve, me qëllim uljen e efekteve negative të gjeneruara nga situata.  
*Encouragement through tax reduction in the tourism and agriculture sectors would increase supply and vitalize these sectors, in order to reduce the negative effects generated by the situation.*

13. April 2020